

**AKTIVITETE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2009**

**PERIUDHA JANAR - TETOR**

<b>Nr.</b>	<b>Data</b>	<b>Aktiviteti i zhvilluar</b>	<b>Organizatori</b>
1	29.01.2009	<p><b>Mbledhje në Komunën Postribë</b></p> <p>Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër z. Gjovalin Kolombi dhe Prefekti i Qarkut Shkodër zoti Maxhid Cungu morën pjesë në mbledhjen e radhës së Këshillit të Komunës Postribë, ku sipas rendit të ditës u bë analiza e punës së kryer nga administrata e komunës Postribë për vitin 2008.</p> <p>Z. Gjovalin Kolombi i cili pasi shfaqti konsideratën e tij pozitive, në mënyrën e organizimit të kësaj mbledhjeje dhe hartimin e materialeve që i ishin servirur nga administrata, tha se Këshilli i Qarkut Shkodër e ndjen detyrimin e tij që ka ndaj kësaj komune, dhe në këtë pikëpamje ai e ka konsideruar Mesin dhe Postribën, si “Porta e Hyrjes” për në Dukagjin nga ana e Shkodrës, prandaj duhet punuar për ta bërë sa më atraktive, jo vetëm për vizitorët por edhe për banorët e saj.</p>	<b>Komuna Postribë</b>
2	30-31 .01. 2009	<p><b>Workshop në Grand Hotel Europa mbi produktet artizanale potenciale për zhvillimin e eko - turizmit</b></p> <p>Në mjediset e Grand Hotel Europa në Shkodër u zhvillua një workshop me temë “Produktet artizanale, potenciale për zhvillimin e Eko-Turizmit dhe si mekanizëm alternativ i punësimit”</p> <p>Ky trajnim u organizua nga Qendra Rajonale e Mjedisit me mbështetjen e Ambasadës së Spanjës në Shqipëri. Objektivi i këtij trajnimi ishte promovimi i</p>	<b>Qendra Rajonale e Mjedisit Ambasada e Spanjës</b>

		<p>kapaciteteve lokale në prodhimin e produkteve artizanale, si vlerë e rëndësishme për zhvillimin e eko-turizmit në Qarkun e Shkodrës. Përmirësimi i koncepteve të marketingut, standartet dhe çertifikimi i produkteve sipas standardeve të BE, si mjet i promovimit të prodhuesve artizanë, në mes vendeve evropiane. Në ditën e dytë morën pjesë specialistë me eksperiencë lokale në prodhimet e artizanatit nga Qarku i Shkodrës, Mali i Zi, profesorë të Universitetit “L.Gurakuqi”, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë etj.</p> <p>Në këtë takim mori fjalën dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, zoti Gjovalin Kolombi, i cili ndër të tjera theksoi : “Shoqëria moderne e konsumit, e ngopur me prodhime në seri industriale, po kthen gjithnjë e më tepër vëmendjen e saj në vlerat e papërsëritshme të artizanatit të mirëfilltë. Këtë tendencë të përgjithshme duhet ta shfrytëzojmë në dobi të ekonomisë sonë individuale dhe shoqërore. Prodhimet artizanale nuk njohin kufinj shtetesh. Ato janë një mjet shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit, sidomos atij kufitar.”</p>	
<b>3</b>	<b>10. 02. 2009</b>	<p><b>Në mbështetje të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal</b></p> <p>Në ambjentet e Hotel Grand Europa, në Shkodër, u zhvillua një takim në mbështetje të decentralizimit dhe zhvillimit local dhe përvoja zvicerane në rajonin e Shkodrës. Në këtë takim morën pjesë dhe ambasadorja e Zvicrës në Tirane zj. Yvana Enzier, prefekti i Shkodrës Z. Maxhid Cungu, kryetarë të qarqeve në rajonin e Veriut dhe kryetarë komunash, partnerë të këtij projekti. Në këtë takim u paraqit puna e lavdërueshme e Interkooperacionit Zviceran në Qarkun Shkodër, në disa komuna të tij, për forcimin e kapaciteteve dhe investimeve të rëndësishme, hartimin dhe botimin e planeve të veprimit strategjik për gjashtë njësi të qeverisjes vendore. Z.Gjovalin Kolombi theksoi: “Dëshiroj të them se megjithëse filozofia e programit ka qenë bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i donatorit me bashkitë dhe komunat partnere, bashkëpunimi i Interkooperacionit me Këshillin e Qarkut ka njohur vazhdimisht rritje. Këshilli i Qarkut, me rolin koordinues të tij,ka qenë një partner aktiv në këtë program. Përfshirja e Këshillit të Qarkut në vlerësimin e projektit më mirë si edhe e KRRT- së tij, në miratimin e planeve të zhvillimit të gjashtë njësive vendore, është një tregues i forcimit të</p>	<b>Inter Coperation</b>

		këtij bashkëpunimi”.	
<b>4</b>	<b>9 -11.02.2009</b>	<p><b>Seminar për Bashkëpunimin Ndërkombëtar.</b></p> <p>Pranë Hotel Grand Europa u zhvillua seminari ndërkombëtar për funksionarët e lartë të administratës publike, rajonale e lokale. Morën pjesë përfaqësues të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe të bashkive Shkodër e Lezhë, të Agjencisë së Zhvillimit Vlorë, të Rajonit Molise, të Agjencisë së Zhvillimit të Molises, të Dhomës së Tregtisë Molise, të Parkut Shkencor-Teknologjik Molise (Itali), të Komunës Kotorr (Mali i Zi), të rretheve Mostar e Brçko (Bosnje-Hercegovinë), të provincës së Vojvodinës dhe të Agjencisë së Zhvillimit Kragujevac (Serbi), të rajoneve Istria, Split dhe Dubrovnik (Kroaci) si dhe përfaqësues të UNOPS-it. Ky seminar formimi tre ditor u zhvillua në kuadrin e projektit të bashkëpunimit mes Rajonit Molise dhe Qarkut Shkodër, financuar nga Ministria e Jashtme Italiane dhe Rajoni Molise, ku dy agjencitë respektive të Zhvillimit GAL Molise dhe TEULEDA Shkodër, janë partnerët implementues të projektit. Pjesa e dytë e këtij seminari do të zhvillohet me 24- 27 shkurt 2009 në Campobasso, Molise.</p>	<b>Rajoni i Molises dhe TEULEDA</b>
<b>5</b>	<b>24 – 27.02.2009</b>	<p><b>Workshop për Bashkëpunim Ndërkufitar</b></p> <p>Në Campobasso (Itali) u zhvillua workshopi me temë “Krijimi i një Bashkëpunimi Ndërkufitar”.</p> <p>Objekti i këtij workshopi ishte krijimi i një rrjeti bashkëpunimi, sigurimi i instrumenteve për ndërtimin e një partenariati, ku të pranishëm ishin Presidenti i Rajonit të Molises z. Michele Iorio, z. Giovanni di Stasi, i deleguari special i sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Europës për Eurorajonin, z. Gianfranco VITAGLIANO, ekspert programimi në Rajonin Molise, z. Francesco Cocco këshilltar i Presidentit të Rajonit Molise për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, z. Antonio Di LALLO drejtor i GAL Molise Verso il 2000 scarl. Nga Qarku Shkodër mori pjesë zj. Stela Mardushaj, specialiste e drejtorisë së koordinim- zhvillimit në këshillin e Qarkut Shkodër.</p>	<b>Rajoni i Molises</b>

6	25 – 27.02.2009	<p><b>Seminar mbi menaxhimin e fondeve të IPA-s</b></p> <p>Në ambjentet e Grand Hotel Europa u organizua seminari mbi menaxhimin e fondeve IPA, në kuadër të iniciativës IPA-CBC Shqipëri-Mal i Zi. Seminari u organizua nga ITAP (Instituti i Trajnimit të Administratës Publike) me mbështetjen e Agjencisë Gjermane GTZ.</p> <p>Të pranishëm si trajnues ishin Z. Arben Kashahu (sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit), znj. Greta Rakaj dhe Sonila Muskaj, nga Ministria e Integritimit. Pjesëmarrësit në trajnim ishin përfaqësues të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, Këshillit të Qarkut Lezhë, Bashkisë Shkodër, përfaqësues nga ente publike shtetërore si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ky aktivitet u hap me përshëndetjen e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Gjovalin Kolombi, i cili e vlerësoi shumë të dobishëm zhvillimin e këtij seminari për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të administratës, për të hartuar dhe menaxhuar në mënyrë profesionale projekte të financuara nga çdo donator i mundshëm.</p> <p>Organizimi i këtij trajnimi kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve të administratës publike për hartimin dhe menaxhimin e projekteve në kuadër të iniciativës IPA CBC (Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi), për të cilën së afërmi do të shpallet thirrja për projekte propozime. Meqënëse administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër, prej disa kohësh, po përgatitet të jetë hartuese në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar, trajnimi u përqëndrua kryesisht në etapat e hartimit të një projekti.</p>	<p><b>ITAP dhe GTZ Këshilli i Qarkut</b></p>
7	30.03.200	<p><b>Zhvillimi Rajonal dhe sfidat për Shqipërinë.</b></p> <p>Në sallën e këshillit të Qarkut u zhvillua një tryezë rajonale mbi rolin e Qarkut, i cili konsiston në koordinimin ndërmjet nivelit të parë të qeverisjes vendore dhe atij qendror, si dhe në koordinimin e politikave kombëtare dhe vendore në nivel rajonal. Ky takim u organizua nga Platforma-IDR, Instituti për Demokraci dhe Reforma, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, me mbështetjen e Fondacionit “Hans Seidel”.</p>	<p><b>Platforma IRD Instituti për Demokraci Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë Këshilli i Qarkut</b></p>

		Në këtë takim shprehen opinionet e tyre në lidhje me rolin që duhet të kenë qarqet, z. Besnik Alia, përfaqësues i IDR, z. Hysen Domi dhe z. Gjovalin Kolombi, të cilët u bashkuan me idetë e auditorit për sfidat dhe drejtimit kryesore, ku duhet të punohet në nivel qarku. Ky është takimi i parë, i cili do të pasojë dhe të tjerë, në njëmbëdhjetë qarqet e vendit.	
8	7.04.2009	<p><b>Proçesi i Planifikimit dhe Zhvillimit Rajonal në Qarkun Shkodër</b></p> <p>Në ambjentet e Grand Hotel Europa Këshilli i Qarkut Shkodër organizoi një takim me temë “Proçesi i Planifikimit të Zhvillimit Rajonal në Qarkun Shkodër”. Morën pjesë Kryetari i Këshillit të Qarkut, z. Gjovalin Kolombi, prefekti i Shkodrës, z. Maxhid Cungu, znj. Valeri Petters dhe Gero Wiescholleck ( përfaqësues të GTZ në Shqipëri), znj. Merita Kazazi (drejtore e Koordinim - Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Shkodër, të cilët morën fjalën në këtë forum. Më poshtë po citojmë pjesë nga fjalimi i kryetarit të Këshillit të Qarkut, z. Kolombi, duke krijuar një sintezë të shkurtër të këtij aktiviteti : “Në kontekstin e këtij procesi, Këshilli i Qarkut Shkodër, ka nënshkruar me GTZ një marrëveshje, mbi bazën e të cilës GTZ do të mbështesë hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut. Gjithashtu, agjencitë e tjera të zhvillimit si ADA, SDC, Intercoopertion Zviceran, SNV dhe gjithë ekspertët, që kanë studiuar gjendjen e qarkut tonë dhe që përveç mbështetjes financiare, kanë dhënë rekomandime të vlefshme për ndërhyrje në zhvillimin e tij. Bashkëpunimi i harmonizuar ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe donatorëve dhe të këtyre të fundit ndërmjet tyre, është dhe do të jetë garanci për rezultate në punën tonë për hartimin e strategjisë”.</p>	<b>Këshilli i Qarkut dhe GTZ</b>
9	20-24 .04. 2009	<p><b>Trajnim për Moderatore dhe Facilitatorë</b></p> <p>Në ambjentet e Grand Hotel Europa u zhvillua një trajnim i përbashkët në me specialistë të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe atij Lezhë, në kuadrin e proçesit të planifikimit të zhvillimit rajonal . Në këtë trajnim, pjesëmarrësit u aftësuan për teknikat e moderimit dhe facilitimit. Ky trajnim u organizua nga GTZ, sipas marrëveshjes së nënshkruar , mbi bazën e të cilës GTZ do të mbështesë hartimin</p>	<b>GTZ dhe Këshilli i Qarkut</b>

		e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut.	
<b>10</b>	<b>5,6,7 . 05. 2009</b>	<p><b>Cikël takimesh mbi moderimin e procesit të hartimit të Strategjisë Rajonale</b></p> <p>Këshilli i Qarkut Shkodër me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) , organizoi një cikël tre ditor takimesh për mbledhjen e opinioneve të aktorëve të ndryshëm lokale, mbi potencialet dhe problematikat në Qarkun e Shkodrës, për hartimin e një dokumenti përfundimtar që do shërbejë si bazë e rëndësishme për hartimin e strategjisë rajonale.</p> <p>Moderimi i këtij procesi takimesh u realizua nga specialistët e Këshillit të Qarkut Shkodër, të cilët janë trajnuar nga GTZ për tu aftësuar mbi teknikat e moderimit.</p> <p>Këtë e proces e mbështeti gjithashtu eksperti i GTZ, Z. Gero Wiescholleck.</p> <p>Temat e përzgjedhura si të rëndësishme për tu diskutuar me aktorët lokalë ishin: Zhvillimi ekonomik dhe Agrobiznesi (Gero Wiescholleck, Kastriot Kruja), Arsimi dhe Shëndetësia (Arbana Dibra, Stela Mardusha), Turizmi dhe Mjedisi (Etleva Papeka, Dorela Mema) Infrastruktura dhe Energjia e Rinovueshme (Kastriot Kruja, Liri Cekaj).</p> <p>Në këtë fazë të parë të këtij cikli u diskutuan dhe u dhanë mendime mbi secilën prej temave të mësipërme, duke dalë në potenciale dhe problematika, të cilat do të jenë bazë e rëndësishme për diskutimet e detajuara në fazën e dytë të procesit, që do të zhvillohet në fillim të Qershorit në Këshillin e Qarkut Shkodër.</p>	<b>Këshilli i Qarkut dhe GTZ</b>
<b>11</b>	<b>10.05.2009</b>	<p><b>Në kuadrin e punës përgatitore për festivalin e Gjirokastrës</b></p> <p>Në Qarkun e Shkodrës janë organizuar grupet artistike të të gjithë komunave, të cilat do të paraqiten para komisionit përzgjedhës me nga një shfaqje në territorin e komunës. Deri tani kanë dhënë shfaqje komunat Vig-Mnelë, Bashkia Vau i Dejës, komuna Hajmel, komuna Dajç.</p> <p>Këto shfaqje janë mirëpritur nga spektatorët e sidomos nga të rinj e të reja.</p> <p>Komisioni qendror, ngritur pranë Këshillit të Qarkut, ka qenë i pranishëm dhe ka bërë përzgjedhjet bazuar në kriteret e festivalit për nuancat më të mira. Me këto përzgjedhje në çdo rreth Shkodër, Pukë, Malësi e Madhe, do të krijohen grupet</p>	<b>Këshilli i Qarkut</b>

		<p>në shkallë rrethi, të cilat do të testohen nga komisioni i Ministrisë së Kulturës për të krijuar grupin pjesëmarrës në shkallë Qarku.</p> <p>Shfaqjet në komuna vazhdojnë dhe me datën 17 maj do të prezantohen komunat Velipojë, me datën 20 komuna Rrethina, me datën 28 komuna Dajç etj. Komunat e tjera vazhdojnë fazën përgatitore.</p>	
12	11.05. 2009	<p><b>Takim mbi rolin e Qarqeve.</b></p> <p>Në sallën e Këshillit të Qarkut Shkodër, me iniciativë dhe ftesë të kryetarit të Këshillit të Qarkut, z. Gjovalin Kolombi, u zhvillua një takim në mes të administratës së këtij institucioni, nëpunësve të Prefekturës Shkodër me profesor Massimo Carli (Universiteti i Firencës), për të drejtën rajonale. Avv. Carli ka një përvojë të madhe në fushën e legjislacionit rajonal në Itali, pasi ai ka punuar në institucione të rëndësishme në shtetin e tij, si në gjykatën kushtuese dhe universitetin e Firences. Biseda u zhvillua mbi krahasimin e evoluimit të decentralizimit në nivel qarku, duke marrë si model rajonet italiane. U paraqitën, nga ana e relatorit, parimet bazë mbi të cilat janë ngritur qarqet në Itali dhe funksionimi i tyre. Domosdoshmëria për të qenë sa më afër qyteteve në qeverisje, zhvillimi jo i diferencuar i komunave në një rajon, që sot aktualisht mbështetet dhe nga Bashkimi Europian, ishin dy nga çështjet kryesore gjatë kësaj bisede. U krahasuan dhe dispozitat legjislative që përmbajnë kushtetutat respektive mbi rajonet. Të gjithë bashkëbiseduesit dhe relatori ranë dakord mbi rolin e rëndësishëm që kanë qarqet, dhe pse duhet forcuar ky rol si dhe mbi problemet që ekzistojnë sot edhe në qarqet evropiane. Sidoqoftë, një rol i forcuar i qarqeve, në bashkëpunim me komunat dhe pushtetin qendror, do të ishte më efikas në zgjidhjen e shumë shërbimeve dhe politikave rajonale në favor të qytetarëve.</p>	<b>Këshilli i Qarkut</b>
13	8.05.2009	<p><b>Takim mbi promovimin e Observatorit të Vëzhgimit të të Drejtave të Fëmijëve.</b></p> <p>Takimi u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Qarkut, dhe pati si qëllim nxitjen e bashkëpunimit të institucioneve të pushtetit vendor në zbatimin e të</p>	<p><b>Shoqata “Aleanca për Fëmijë”</b>  <b>Këshilli i Qarkut</b>  <b>UNICEF</b></p>

		<p>drejtave të fëmijëve, si dhe promovimin e Observatorit të Vëzhgimit të të Drejtave të Fëmijëve.</p> <p>Fjala e mirëseardhjes u mbajt nga nënkryetari i Këshillit të Qarkut të Shkodrës, Z.Hajrulla Gjekaj.</p> <p>Takimi u zhvillua me iniciativën e shoqatës“Aleanca për Fëmijë”, me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të UNICEF-it dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Në këtë takim u prezantua projekti për ngritjen e Njësisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në qark, zhvillimet e fundit në lidhje me institucionalizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar, si dhe integrimin e qarqeve në këtë proces.</p>	<p><b>Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.</b></p>
14	17.05.2009	<p><b>Panairi Rajonal i Agrobiznesit</b></p> <p>Zhvillohet, për të dytin vit radhazi në Shkodër, panairi Rajonal i Agrobiznesit. Në këtë edicion ishin të pranishëm rreth 200 biznese nga zonat e veriut të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës.</p> <p>Ky aktivitet i zhvilluar për dy ditë me radhë, me datat 15-16 maj, u organizua nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Shkodër, Këshilli i Qarkut Shkodër, Shoqata Kombëtare e Agrobiznesit. Të pranishëm, përveç autoriteteve lokale në ceremoninë e rastit ishte edhe ministri i bujqësisë Z. Jemin Gjana. Në fjalën e tij ministri Gjana theksoi domosdoshmërinë e investimeve në bujqësi dhe blegtori, si dhe nevojën që shteti të mbështesë këta sektorë. Tashmë pas kaq shumë investimesh dhe vëmendje nga shteti, mund të themi se jemi të integruar në tregjet rajonale, Ballkanike, por nuk mund të themi të njëjtën gjë, për praninë tonë në tregjet evropiane. Për të qenë pjesë e këtyre tregjeve duhet të plotësohen shumë kushte, për të cilat kemi nisur të punojmë, kanë deklaruar folësit.</p>	<p><b>Drejtoria e Bujqësisë Këshilli i Qarkut Shoqata Kombëtare e Agrobiznesit</b></p>
15	27.05.2009	<p><b>Mbledhja e radhës së Këshillit të Qarkut Shkodër</b></p>	<p><b>Këshilli i Qarkut</b></p>

		<p>Në këtë mbledhje të Këshillit të Qarkut Shkodër, u trajtuan disa materiale të paraqitura nga administrata e këtij institucioni, ndër të cilat theksohen: “Për përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Qarkut në raste emergjence”, “Për miratimin e fondit për mbështetje financiare nga Këshilli i Qarkut Shkodër, për organizimin e Panairit Rajonal Agrobiznes 2009 në Shkodër”, “Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me GTZ, për financime të projekteve në kuadër të mbështetjes së zhvillimit ekonomik”, “Hartimin dhe miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2010-2012”, “Administrimin e fondit të besuar”, “Për sistemim në segmentin rrugor, shtrim me çakull, aksi rrugor nr. 2 Shkodër”, “Miratimin e orareve shtesë në linjën Shkodër- Koplík”, “Miratim i linjës së transportit rreth-qytetase, Bushat-Shkodër dhe kthim në oraret përkatëse”, “Për miratim e linjës së transportit ndër-qytetase në linjën Guri i Zi-Velipojë e kthim me 5 (pesë) orare lëvizëse”, “Miratim i linjës së transportit rreth-qytetas Shkodër-Fushë-Arrëz e kthim, me 2 (dy) orare lëvizëse”, “Miratim i linjës së transportit rreth-qytetas Fushë-Arrëz--Shkodër dhe kthim me 3 (tre)orare”, “Për transport udhëtarësh në linjën e rregullt Koplík-Shkodër e kthim”, “Për miratimin e propozimit të shoqatës së piktorëve për dhënien e titullit “Nderi i Kombit” piktorit të madh Kolë Idromeno”.</p>	
16	2.06.2009	<p><b>Takim mbi rolin e Shoqërisë Civile dhe Pushtetit Lokal</b></p> <p>Në sallën e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua një takim informativ, për rolin bashkëveprues që luan shoqëria civile dhe pushteti lokal në procesin e integritimit evropian. Në këtë takim u bë prezantimi i një vëzhgimi të realizuar në gjashtë qarqe të vendit, në lidhje me problemet që NGO- të hasin në kuadrin e qëndrueshmërisë dhe arritjes së standarteve në nivelin e BE –së. Në këtë takim u trajtuan tema të ndryshme si marrëveshja e stabilizim asocimit, dispozitat dhe roli i pushtetit lokal në këtë kuadër, cilat janë mesazhet e përbashkëta nga dy sektorët, nga qeverisja lokale dhe shoqëria civile. Ky takim u organizua nga Ministria e Integritimit me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Shkodër.</p>	<p><b>Ministria e Integritimit Këshilli i Qarkut</b></p>

		Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të Ministrisë së Integritimit etj.	
17	11.06. 2009	<p><b>Prezantimi i programit IPA CBC Shqipëri - Mali i Zi</b></p> <p>Në ambjentet e Grand Hotel Evropa u zhvillua takimi për prezantimin e Programit IPA ( Instrumenti i para aderimit), programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi, financuar nga Bashkimi Evropian. Ky takim u organizua nga Ministria e Integritimit e Republikës së Shqipërisë me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Shkodër.</p> <p>Në këtë takim ishin të pranishëm Z. Arben Kashahu Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit, Znj. Greta Rakaj, përgjegjëse e njësisë së bashkëpunimit rajonal në Ministrinë e Integritimit, Znj. Albana Hana specialiste në sektorin e bashkëpunimit rajonal në Ministrinë e Integritimit, gjithashtu ishte e pranishme dhe një përfaqësuese nga Sekretariati i Integritimit Evropian i Republikës së Malit të Zi. Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër Z. Gjovalin Kolombi, i cili fillimisht falenderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre në këtë sesion. Z. Kolombi në fjalën e tij vuri theksin në përgatitjen e projekteve të përbashkëta, në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Crossborder, dhe se Qarku i Shkodrës e konsideron të rëndësishme përfshirjen në projekte të tilla, si dhe vuri në dukje se rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar dhe fqinjësia e mirë janë një element i rëndësishëm në procesin e integritimit, në Bashkimin Evropian. Më pas fjalën e mori Z. Arben Kashahu, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit, i cili bëri përshëndetjen e rastit në emër të Ministrisë së Integritimit, duke bërë një prezantim të shkurtër të programit IPA Crossborder Shqipëri-Mali i Zi.</p>	<b>Ministria e Integritimit Këshilli i Qarkut</b>
18	2, 3, 4,dhe 5. 06. 2009	<p><b>Cikli i dytë mbi moderimin e procesit të hartimit të Strategjisë Rajonale.</b></p> <p>Këshilli i Qarkut Shkodër me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për bashkëpunim teknik GTZ, në ambjentet e Grand Hotel Evropa, organizoi ciklin e dytë katër ditor të takimeve për mbledhjen e opinioneve të aktorëve të ndryshëm</p>	<b>Këshilli i Qarkut GTZ</b>

		<p>lokale, mbi potencialet dhe problematikat në Qarkun e Shkodrës, për hartimin e një dokumenti përfundimtar, që do shërbejë si bazë e rëndësishme për hartimin e strategjisë rajonale të Qarkut Shkodër.</p> <p>Moderimi i këtij procesi u realizua nga specialistët e Këshillit të Qarkut Shkodër, të cilët janë trajnuar nga GTZ për tu aftësuar mbi teknikat e moderimit. Këtë e proces e mbështeti gjithashtu eksperti i GTZ, Z. Gero Wiescholleck.</p> <p>Temat e përzgjedhura si të rëndësishme, për tu diskutuar me aktorët lokalë ishin: Zhvillimi ekonomik dhe Agrobiznesi (Gero Wiesholleck, Kastriot Kruja), Arsimi dhe Shëndetësia (Arbana Dibra, Stela Mardusha), Turizmi dhe Mjedisi (Etleva Papeka, Dorela Mema) dhe Infrastruktura dhe Energjia e Rinovueshme (Kastriot Kruja, Liri Cekaj).</p>	
19	24. 06.2009	<p><b>Bashkëpunim për aplikim në programin IPA, bashkëpunimi ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi.</b></p> <p>Në ambjentet e Grand Hotel Evropa Shkodër, këshilli i Qarkut Shkodër i mbështetur nga shoqata zvicerane Inter Cooperation, organizoi një takim me partnerët e saj në Malin e Zi, në kuadër të programit IPA CBC i financuar nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri.</p> <p>Nga pala shqiptare Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, Z. Gjovalin Kolombi i njohu miqtë me punën që është bërë deri tani nga administrata e këtij qarku dhe komunitat, me të cilat është bashkëpunuar për të fiksuar sipas programit projekt- idetë, me të cilat duhen hartuar dhe projektet përkatëse.</p> <p>Këto projekte u paraqitën nga specialistët dhe konsistonin në kultivimin e ullirit në dy anët e kufirit, sistemimin e lumit Buna në pjesë të përbashkëta ku është e nevojshme, në artizanatin, në turizmin dhe kulturën. Nga ana e palës malazeze kishte përfaqësues nga Bashkia e Podgoricës, e Tivarit dhe e Ulqinit, vende që bëjnë pjesë në hartën e shtrirjes së programit. Nga ana e tyre projekt- idetë u pëlqyen, dhe në këtë kontekst u nënshkrua një memorandum i mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Komunës Bar, që ka për qëllim përfshirjen në përgjegjësi të përbashkëta, në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri dhe në Malin e Zi, alokimi financiar 2007. Duke qenë të vetëdijshëm, se programi i</p>	<b>Këshilli i Qarkut Inter Cooperation</b>

		<p>bashkëpunimit ndërkufitar ka për qëllim të promovojë marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, stabilitet, siguri dhe prosperitet në interes të përbashkët, si dhe stimulimin e zhvillimit të tyre të qëndrueshëm dhe të balancuar.</p> <p>Palët ranë dakord me obligimet e parashikuara sipas deklaratës së partneritetit, të formës së grantit të aplikimit, në momentin e paraqitjes së thirrjes për projekt propozime. Palët do të jenë përgjegjës direkt për përgatitjen, menaxhimin dhe zbatimin e projektit, që do jetë i lejueshëm për bashkëpunim.</p>	
21	14.07.2009	<p><b>Takim me kryetarët e komunave që mbulojnë territorin e “ Bjeshkëve të Namuna”</b></p> <p>Këshilli Qarkut Shkodër në bashkëpunim me Organizatën Hollandeze për Zhvillim, organizoi një takim me kryetarët e komunave që mbulojnë territorin e “ Bjeshkëve të Namuna”, me qëllim prezantim dhe ndarje mendimesh në lidhje me projektin: “ Mbështetje e komuniteteve rurale dhe peisazheve tradicionale, përmes qeverisjes mjedisore në zonat e mbrojtura ndërkufitare të Harkut Dinarik”</p>	<b>Këshilli i Qarkut SNV</b>
22	10.07.2009	<p><b>Takim në komunën e Podgoricës mbi partneritetin në kuadër të IPA – crossborder, Shqipëri – Mali i Zi</b></p> <p>Në kryeqytetin e Malit të Zi, në Podgoricë u zhvillua një takim mbi vendosjen e partneritetit në projekte konkrete, midis palës malazeze dhe asaj shqiptare në kuadër të projektit IPA CBC. Të pranishëm në takim nga pala shqiptare ishin Znj. Merita Kazazi, drejtoreshë e zyrës së koordinim zhvillimit në Qarkun Shkodër, Z. Kastriot Kruja, specialist në Këshillin e Qarkut Shkodër dhe Z. Genc Pasko ekspert i Intercooperation.</p> <p>Z. Genci Pasko bëri një përmbledhje të përgjithshme të punës që ka bërë Këshilli i Qarkut Shkodër për përgatitjen e projekt- ideve, në kuadër të thirrjes së IPA</p>	<b>Komuna Podgoricë</b>

		<p>crossborder Shqipëri – Mali i Zi. Puna ka filluar me njohjen e programit, përzgjedhjen e temave në bazë të masave të lejuara, përgatitjen e kuadrit logjik dhe identifikimin e partnerëve sidomos nga Mali i Zi, si kusht i domosdoshëm për të marrë pjesë në këtë konkurim. U paraqitën shkurtimisht pesë ide. Takimi u realizua si rezultat i interesimit të Komunës Podgoricë, mbas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në Shkodër, ku u theksua interesi i kësaj komune për idenë e artizanatit.</p> <p>Qëllimi i takimit ishte që të vendosen piketat se si do vazhdohet, dhe kush do të jenë partnerët konkretë nga komuna e Podgoricës.</p> <p>Z. Zoran Raicevic bëri një prezantim të gjendjes dhe shkallës së njohjes, së palës malazeze mbi IPA-n. U tregua interes nga komuna e Podgoricës për tre nga pesë idetë e paraqitura nga Qarku Shkodër, më saktësisht në projektet e artizanatit, festivalit folklorik dhe turizmit.</p>	
23	14. 09. 2009	<p><b>Trajnim për Proçedurat e Prokurimit sipas rregullave të IPA-s</b></p> <p>Këshilli i Qarkut Shkodër në funksion të harmonizimit të politikave të pushtetit qëndror me pushtetin vendor, në bashkëpunimin me IC/DLDP-në, ka organizuar një sërë trajnimesh me ekspertë të Agjencisë së Prokurimit Publik për rritjen e kapaciteteve administrative, në mënyrë që specialistët e proçedurave të prokurimit në njësitë vendore të Qarkut Shkodër, të njihen me risitë në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe me procedurat e prokurimit sipas rregullave të IPA-s.</p> <p>Përgatitja e seancave të trajnimit ishte në funksion të problematikave dhe vështirësive, që janë ndeshur gjatë zhvillimit të proçedurave elektronike nga autoritetet kontraktore të Qarkut Shkodër, si dhe njohja me risitë në sistemin e prokurimit elektronik. Në vijim janë zhvilluar trajnime të hollësishme me datë 18, 24, 25 shtator, dhe me datën 6 tetor me 3 specialistë të prokurimit publik për çdo njësi vendore, në zbatim të programit të punës së hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër dhe IC/DLDP.</p>	<b>Këshilli i Qarkut IC/DLDP.</b>

24	7.09.2009	<p><b>Takim informues në kuadër të Programit IPA ADRIATIK</b></p> <p>Në sallën e këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua një takim informativ në kuadër të Programit IPA, me përfaqësues të komunave të Qarkut Shkodër. Ky takim kishte për qëllim dhënien e një informacioni në lidhje me programin e bashkëpunimit IPA ADRIATIK. Përfaqësuesit e komunave të cilët morën pjesë në këtë takim, shprehën interesin për tu njohur me këtë program dhe me plotësimin e dokumentacionit përkatës.</p>	<b>Këshilli i Qarkut</b>
25	15, 16, 17, dhe 18. 09. 2009	<p><b>Cikli i tretë mbi moderimin e procesit të hartimit të Strategjisë Rajonale</b></p> <p>Këshilli i Qarkut Shkodër me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për bashkëpunim teknik GTZ, organizoi ciklin e dytë katër ditor të takimeve mes aktorëve të ndryshëm lokale, mbi potencialet dhe problematikat në Qarkun e Shkodrës, për hartimin e një dokumenti përfundimtar, që do shërbejë si bazë e rëndësishme për hartimin e strategjisë rajonale. Moderimi i këtij procesi takimesh u realizua nga specialistët e Këshillit të Qarkut Shkodër, të cilët janë trajnuar nga GTZ për tu aftësuar mbi teknikat e moderimit. Këtë e proces e mbështeti gjithashtu eksperti i GTZ Z. Gero Wiescholleck.</p> <p>Temat e përzgjedhura si të rëndësishme për tu diskutuar me aktorët lokale ishin: Zhvillimi ekonomik dhe Agrobiznesi, Arsimi dhe Shëndetësia, Turizmi dhe Mjedisi, Infrastruktura dhe Energjia e Rinovueshme.</p>	<b>Këshilli i Qarkut GTZ</b>
26	13.10. 2009	<p><b>Takim me komunitetin në komunat Hajmel dhe Vig - Mnelë</b></p> <p>Në komunën Hajmel me iniciativë të kryetarit të Këshillit të Qarkut zotit Gjovalin Kolombi, u zhvillua një takim i zgjeruar me punonjës të administratës, anëtarë të këshillave komunalë dhe banorë të komunave Hajmel dhe Vig-Mnelë. Në takim merrnin pjesë edhe specialistë të administratës së Këshillit të Qarkut, të fushave të ndryshme. Në këtë takim Z. Gjovalin Kolombi theksoi</p>	<b>Këshilli i Qarkut</b>

	<p>domosdoshmërinë e hartimit të një plani zhvillimi për këto dy komuna dhe tha: “ Se zhvillimi i komunave Hajmel dhe Vig-Mnelë do të vlerësohet dhe do të rishikohet në funksion të procesit të ndryshimeve, që priten të ndodhin në të gjithë rajonin e Shkodrës, pasi në asnjë moment këto komuna nuk mund të shihen të izoluara nga pikpamja e zhvillimit ekonomik dhe social të Qarkut të Shkodrës”.</p> <p>Nga diskutimet e shumta të pjesëmarrësve dolën në pah potencialet natyrore të kësaj zone, që përbëjnë një rezervë të rëndësishme për zhvillimin. Një falenderim të veçantë komuniteti i këtyre dy komunave pati për Z. Gjovalin Kolombi, për këtë nismë që do të sjellë zhvillimin e kësaj zone.</p>	
--	---	--

**Mblodhi dhe përpunoi materialin:**

**L.Çekaj**

**Specialiste, Drejtorja e Koordinimit dhe Zhvillimit**

